



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:060636

Datë: 10.11.2020

Numri i dokumentit: 01260487

P.nr. 1002/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Kushtrim Shyti, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Valbona Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.Xh., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.II.nr.1781/2020, të dt. 29.05.2020 për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës, me datë 10.11.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

MIRATOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1781/2020, a datës 29.05.2020, dhe Gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: SH. XH., nga i ati S., dhe nëna F., e gjinisë G., i lindur me datë *data e lindjes...*, në F., me vendbanim në fshatin B., te banesat e vjetra, bloku 1, hyrja 3, kati 4, numër 14, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 18.04.2020, rreth orës 20:00, në oborrin e shkollës fillore "D.B." në F.K., i pandehuri Sh.Xh., me dashje ka dëmtuar një dritare së bashku me xham të objektit të shkollës fillore "D.B." në F. K.

Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 69 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

1. I akuzuari: Shqipdon Xhata dënohet me gjobë në shumë prej 300.00 € (treqind euro), të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
2. Të njëjtin dënim të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë, me dy këste me se largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.
3. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 20€, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.1781/2020, të dt. 29.05.2020, e ka akuzuar Sh.Xh., se ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjyqtari i çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e posaçërisht raportin e policisë me Nr. të rastit 2020-AE-0385 i dt. 19.04.2020, Kallëzimi penal Nr. 2020-AE-0385 dt: 25.04.2020, foto dokumentacioni, deklaratat e vet të pandehurit si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPP RK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.nr.1002/20, të datës 10.11.2020

Zyrtare Ligjore,
Valbona Shabani

G j y q t a r i
Kushtrim Shyti

KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi – urdhri ndërshtimor, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.